



Water and Waste Regulatory Office
Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina
Regulatorni Ured za Vodu i Otpad

UNMIK



ZRRUM – R 06 / W&WW

ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA (“ZRRUM”)

RREGULL
PËR FALJEN DHE RREGULLIMIN E BORXHEVE TË VJETRA
NGA
OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA NË
KOSOVË

26 Janar 2005

TABELA E PËRMBAJTJES

PJESA I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	3
Neni 1: Autoriteti për këtë Rregull.....	3
Neni 2: Përfshirja	3
Neni 3: Qëllimi.....	3
Neni 4: Definicionet.....	3
Neni 5: Rregullat e Interpretimit	6
Neni 6: Aplikueshmëria	6
PJESA II: PARIMET E PËRGJITHSHME	6
Neni 7: Parimet Themelore	6
PJESA III: PROCEDURAT	7
Kapitulli 1: Borxhet e Vjetra.....	7
Neni 8: Falja dhe Rregullimi i Borxheve të Vjetra	7
Neni 9: Kushtet për Faljen dhe Rregullimin e Borxheve të Vjetra	7
Neni 10: Shlyerja e Borxhit të Vjetër.....	7
Kapitulli 2: Marrëveshjet për Pagesa dhe Kontestet.....	8
Neni 11: Marrëveshjet për Pagesa.....	8
Neni 12: Kontestimi i Besueshëm i Faturës	8
Neni 13: Mos Pagesa e Vazhdueshme	9
Kapitulli 3: Situatat e Veçanta	9
Neni 14: Të Varfrit dhe të Vobektit	9
Neni 15: Pronat e Braktisura ose të Boshatisura.....	9
Neni 16: Pronari i Ri ose Banuesi	10
Kapitulli 4: Shënimet dhe Raportet.....	10
Neni 17: Shënimet.....	10
Neni 18: Raportet	10
PJESA IV: TË NDRYSHME	11
Neni 19: Gjuhët Zyrtare të këtij Rregulli	11
Neni 20: Hyrja në Fuqi.....	11
Neni 21: Afati.....	11
SHTOJCAT	12
SHTOJCA 1.....	13
SHEMBULL I FORMULARIT PËR PËRMbledhjen e BORXHEVE TË VJETRA. 13	
SHTOJCA 2.....	15
MODELI I KONTRATËS PËR MARRËVESHJEN E PAGESËS	15

PJESA I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1: Autoriteti për këtë Rregull

Rregullatori lëshon këtë Rregull sipas autorizimit të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve për Ujë dhe Mbeturina në Kosovë.

Neni 2: Përfshirja

Të gjithë Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza të cilët aktualisht operojnë në Kosovë do të zbatojnë këtë Rregull vetëm një herë për faljen dhe rregullimin e Borxheve të Vjetra të papaguara të cilat Konsumatorët e tyre i kanë borxh.

Neni 3: Qëllimi

3.1 Qëllimi i kësaj Rregulle është të:

- (a) Ndhimjohë (lehtësojë) punën efikase dhe të qëndrueshme të Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza për të siguruar shërbime efikase;
- (b) Krijohë procedurat, afatet dhe kushtet e aplikueshme për Konsumatorët për të përfituar nga falja e Borxheve të tyre të Vjetra dhe nga rregullimi i Borxheve të Vjetra për pjesën e cila nuk do të falet; dhe
- (c) Ndhimjohë Ofruesin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza të shlyejë nga librat e tyre Borxhet e Vjetra të cilat vështire së do të inkasohen.

3.2 Pranueshmëria për faljen ose rregullimin e Borxheve të Vjetra për Konsumatorin në pajtim me këtë Rregull është e kushtëzuar me përgjegjësinë për të paguar të gjitha Faturat ose njohjen e pamundësisë së tyre për të bërë një gjë të tillë, si dhe lidhjen e marrëveshjes me shkrim me Ofruesit e tyre për Shërbime të Ujit dhe Ujërave të Zeza.

Neni 4: Definicionet

Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregull do të përmbajnë kuptimet si në vijim:

Borxhi i Vjetër nënkupton të gjitha borxhet e Konsumatorit të evidentuara nga faturat e pakontestueshme të lëshuara nga Ofruesi i Shërbimeve të ai Konsumator më ose pas 31 dhjetorit 2002, të cilat nuk janë paguar në tërësi siç janë definuar dhe rregulluar në Rregullën e caktuar për Borxhet e Vjetra të lëshuar, ndryshuar apo plotësuar nga Rregullatori kohë pas kohe;

Depoziti për Garanci nënkupton depozitin e kërkuar Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza;

Ditë Pune nënkupton çdo ditë përveç të shtunës dhe të dielës, apo ditë tjetër që është festë zyrtare në Kosovë;

Falja e Borxhit të Vjetër nënkupton Ofruesin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza, si kreditor do të ndërpresë cilindo veprim në vazhdim e sipër ose në të ardhmen ndaj secilit Konsumatorë borxhli që të mbledhë ndonjë Faturë të papaguar apo pjesë të sajë nga kjo dhe do të shlyejë shumën e falur nga shënimet e veta afariste;

Faturë nënkupton njoftimin me shkrim për të paguar për Shërbimet e Ujit dhe Ujërave të Zeza, e cila saktëson shumën e borxhit të pagueshëm, dhe periudhën gjatë së cilës janë

ofruar shërbimet, që i lëshohet Konsumatorit nga Ofruesi i Shërbimeve tek Konsumatori në gjuhën Shqipe dhe Serbe;

Gjendje e Mirë nënkupton në lidhje me një Konsumatorë të Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza, që ai Konsumator i ka paguar Faturat e tij të pakontestueshme brenda njëzetekatër (24) ditëve nga data kur ajo faturë ka qenë e caktuar për t'u paguar, apo që ka lidhë dhe është në pajtim me Marrëveshjen për Pagesë me Ofruesin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza;

Komisioni Këshillues i Konsumatorëve nënkupton komisionin e themeluar nga Rregullatori për secilën Zonë të Shërbimit për të hulumtuar dhe zgjidhur Ankesat e Konsumatorëve.

Konsumator nënkupton çdo person që ka lidhë Kontratën për Shërbime të Ujit dhe Ujërave të Zeza apo kontratën për Furnizim me Ujë me Shumicë që në mënyrë të ligjshme ka marrë Shërbime për Ujë të furnizuara nga Ofruesi i Shërbimeve;

Prona e Braktisur ose e Zbrazët nënkupton Pronën e Paluajtshme e cila më herët ka qenë e kyçur në shërbime të ujit dhe është shkyçur për shkak të mungesës së banimit të njerëzve ose për shkak të kërkesës së pronarit ose banuesit;

- i. **Konsumator Shtëpiak** nënkupton Konsumatorin e klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si person i cili shfrytëzon Shërbimet në banesën ose amvisërinë e tij apo saj;
- ii. **Konsumator Komercial/Industrial** nënkupton cilindo person, subjekt ligjor ose organizatë afariste të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si Konsumatori i cili shfrytëzon Shërbimet për apo në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së vet industriale apo komerciale të cilit do lloj;
- iii. **Konsumator Institucional** nënkupton cilindo subjekt ligjor të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si autoritet qeveritar, autoritet lokal, organizatë ndërkombëtare apo institucion i cili kryen veprimtaritë të interesit të përbashkët apo publik dhe i cili nuk është i regjistruar si organizatë afariste në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Mbi Regjistrimin e Organizatave Afariste në Kosovë.

Kontestimin i Besueshëm i Faturës nënkupton kontestimin për një Faturë të lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza që është inicuar me shkrim nga Konsumatori para se asaj fature t'i kalojë afati i pagesës, duke siguruar se shuma totale e pagueshme e tejkalon mesataren e konsumit sezonal të paguar nga ai Konsumator gjatë periudhës (12) mujore para datës së faturës prej më së paku njëzet përqind (20%) dhe një kontestim i tillë nuk është i paarsyeshëm ose irritues;

Kontrata e Shërbimit nënkupton marrëveshjen në mes Ofruesit të Shërbimit dhe Konsumatorit;

Kyçje e Paligjshme nënkupton lidhjen në mes të pronës së Personit dhe rrjetit shpërndarës për Shërbimeve të Ujit të furnizuara nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza i cili nuk është krijuar nga ai Ofrues i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza ose pararendësve të tij sipas ligjit të aplikueshëm;

Lista e Tarifave të Shërbimeve nënkupton të gjitha Tarifat e aplikueshme të Shërbimeve për Zonën e Shërbimeve duke përfshirë Tarifat për llojin e shërbimeve, lokacioni dhe kategoria e Konsumatorëve dhe ngarkesat për Shërbimet e Ujit dhe Ujërave të Zeza që iu ofrohen Konsumatorëve të cilat janë të aprovuara nga Rregullatori;

Llogaria e Papaguar nënkupton llogarinë në mes të Konsumatorit dhe Ofruesit të Shërbimeve të Ujit e cila nuk është paguar nga Konsumatori në orarin e rregullt të punës, ku Konsumatori ka marrë njoftimin për shumën që duhet të paguhet dhe kohën e arsyeshme për t'a paguar.

Marrëveshja për Pagesë nënkupton marrëveshjen në mes të Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Konsumatorit me qëllim që të paguhet ose të falen Borxhet dhe siç definohej dhe rregullohen në Rregullën e caktuar për Borxhet e Vjetra të lëshuar, ndryshuar dhe/apo të plotësuar nga Rregullatori kohë pas kohe;

Ndërmarrje Shoqërore ka kuptimin e njëjtë sikurse në Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 të 13 qershorit 2002 “Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”, domethënë: Ndërmarrja e cila është krijuar si pronë shoqërore nën Ligjin për Ndërmarrje. Ligjin për Punën e Bashkuar të Republikës Federale të Jugosllavisë ose ndonjë ligj tjetër të aplikueshëm në Kosovë;

Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza nënkupton Personin që ofron apo që mendon të ofrojë Shërbime të Ujit dhe Ujërave të Zeza; dhe

Person i Varfër nënkupton Konsumatorin e regjistruar në Skemën e Ndihmës Sociale të Kosovës ose skema të ngjashme që drejtohen nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale;

Person nënkupton një individ, subjekt legal apo publik përfshirë korporatë, ortakëri, trust, organizatën jokorporuese, një qeveri apo cilëndo agjenci apo nënsektor të saj;

Prona e Paluajtshme nënkupton tokën dhe ndërtesat, instalimet ose strukturat në ose në sipërfaqen e tokës që janë të kyçura të vendosura në tokë. Prona e patundshme do të përfshijë njësitë brenda ndërtesave, përfshirë por jo e kufizuar në, apartamentet ose zonat për aktivitetet komercial;

Rregullatori nënkupton autoritetin përgjegjës për rregullimin ekonomik të Ofruesve të Shërbimeve për Ujë dhe Mbeturina. Gjithashtu referohet si “Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (“ZRRUM”) e krijuar nën Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave në Kosovë apo organizatën e saj pasardhëse;

Rregullimi i Borxheve të Vjetra nënkupton sistemin me të cilin Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza pajtohet të shkarkoj Konsumatorin që të paguajë në tërësi ose pjesërisht cilindo Borxh të Vjetër sipas kushteve dhe afateve të Marrëveshjes për Pagesë;

Shërbimet e Ujit nënkupton nxjerrjen, përpunimin, dhe shpërndarjen e ujit për konsum njerëzor dhe operimin e rrjetit dhe objekteve për atë qëllim.

Shërbimet për Ujëra të Zeza nënkupton grumbullimin, derdhjen, dhe trajtimin e ujërave të zeza dhe të kanalizimit.

Shkyçje nënkupton ndërprerjen e ndërlidhjes në mes objektit të Konsumatorit dhe rrjetit shpërndarës për Shërbimet e Ujit i cili mundëson që Konsumatori të merr këto Shërbime nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza dhe “Shkyç”, “duke Shkyçur” dhe “I Shkyçur” do të ketë kuptim të ngjashëm;

Skema e Ndihmës Sociale nënkupton programin e administruar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të Kosovës (“MPMS”) ku vendosen kriteret dhe çertifikon pranueshmërinë për zgjedhjen e personave të varfër ekonomikisht sipas Rregullosës së UNMIK-ut Nr. 2003/28, Ligjit Nr. 2003/15 Mbi Shpalljen e Ligjit të adoptuar nga Kuvendi i Kosovës mbi Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë;

Tarifa e Shërbimit nënkupton çdo vlerë, ngarkesë ose taksë e Ofruesit të Shërbimeve në lidhje me ofrimin e Shërbimeve veta për Konsumatorët;

Neni 5: Rregullat e Interpretimit

Në këtë Rregull:

- (a) Cilatdo fjalë dhe shprehje të përdorura në këtë Rregull, që nuk janë definuar posaçërisht dhe të cilat mund të jenë të paqarta, do të përmbajnë kuptimet e atilla siç janë të definuara në aktet ligjore të përmendura në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave në Kosovë që autorizojnë këtë Rregull ose në cilindo ligj tjetër të aplikueshëm në Kosovë; dhe
- (b) Referencat në Rregull do të interpretohen sipas kuptimit të cilësdo Rregull të lëshuar, të modifikuar, ndryshuar, plotësuar, dhe/ose të zëvendësuar nga Rregullatori kohë pas kohe në pajtim me pushtetin që i është dhënë Rregullatorit; dhe
- (c) Njëjësi përfshinë shumësin dhe anasjelltas; dhe
- (d) Fjalët e cilësdo gjini që përdoren në Rregulloren aktuale do të përfshijnë cilëndo gjini tjetër; dhe
- (e) Referencat për Pjesët, Kapitujt, dhe Nenet, përveç nëse shprehimisht nuk janë deklaruar ndryshe, janë referenca për Pjesë, Kapituj dhe Nene të këtij Rregulli.

Neni 6: Aplikueshmëria

Nga të gjithë Ofruesit ekzistues të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza kërkohet që të respektojnë këtë Rregull nëse dëshirojnë të falin ose në ndonjë formë tjetër të rregullojnë Borxhet e Vjetra.

PJESA II: PARIMET E PËRGJITHSHME

Neni 7: Parimet Themelore

7.1 Asgjë e përcaktuar me këtë Rregull nuk duhet të interpretohet se:

- (a) Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza shkarkohen prej obligimit për ofrimin e shërbimeve ndaj Konsumatorëve dhe Konsumatorët prej obligimit për pagesën e Faturave të dorëzuara për shërbimet e marrura.
- (b) Parandalohet që Konsumatori ti nënshtrohet Shkyçjes në rast se nuk ka paguar Faturat e veta brenda kufijve kohor të caktuar ose i cili nuk ka lidhë marrëveshje me shkrim me Ofruesin e Shërbimeve për një orar të përshtatur për pagesë;
- (c) Parandalohet që Konsumatori të kontestojë besueshëm, shumën e Faturës duke dorëzuar Ankesën e Konsumatorëve sipas procedurave të përcaktuara nga Rregullatori.

7.2 Duke u bazuar në parimet e paraqitura më lartë, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza, me lejen e Rregullatorit dhe në mënyrë jo-diskriminuese mund të falë dhe të shlyejë Borxhin e Vjetër ose të bie në pajtim me Konsumatorin për

shlyerje sa herë që është e domosdoshme për shkak të arsyeve të zakonshme ekonomike dhe menaxheriale.

PJESA III: PROCEDURAT

Kapitulli 1: Borxhet e Vjetra

Neni 8: Falja dhe Rregullimi i Borxheve të Vjetra

- 8.1 Borxhet e Vjetra të evidencuara nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza në Faturat e lëshuara para 31 dhjetorit 2000 do falen në njëqind përqind (100%) të vlerës së tyre.
- 8.2 Borxhet e Vjetra të evidencuara nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza në Faturat e lëshuara për Konsumatorët e Amvisërisë, Industrial dhe Komercial nga 1 janari 2001 deri më 31 dhjetor 2001 do të jenë të falura pesëdhjetë përqind (50%) nga shuma e tij, duke qenë pjesa tjetër e mbetur e borxhit e obligueshme dhe e pagueshme në tërësi.
- 8.3 Borxhet e Vjetra të evidencuara nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza në Faturat e lëshuara nga 1 janari 2001 deri më 31 dhjetor 2001 për Konsumatorët Institucional dhe Ndërkombëtarë do të jenë të pagueshme dhe do të paguhen në tërësi.
- 8.4 Borxhet e Vjetra të evidencuara nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza në Faturat e lëshuara nga 1 janari 2002 deri më 31 dhjetor 2002 për të gjithë Konsumatorët do të jenë të pagueshme dhe të do të paguhen në tërësi.

Neni 9: Kushtet për Faljen dhe Rregullimin e Borxheve të Vjetra

Falja dhe Rregullimi i Borxheve të Vjetra mund të bëhet sipas kushteve në vijim:

- (a) Konsumatori nënshkruan Kontratën për Shërbime;
- (b) Konsumatori do të jetë i detyrueshëm të paguajë në tërësi cilindo Borxh të Vjetër i cili nuk është falë sipas Rregullimeve për Pagesë të parapara në dispozitat e Kapitulli 2;
- (c) Konsumatori do të bëjë ta bëjë të njohur çfarëdo Kyçje të Paligjshme në Rrjetin e Ujit dhe Ujërave të Zeza dhe të merr përsipër që më tutje mos të vazhdojë me Kyçje të Paligjshme;
- (d) Falja e Borxheve të Vjetra do të anulohet nëse Konsumatori dështon të paguajë pjesën e Borxhit të Vjetër i cili nuk është i falur që ka të bëjë me afatet dhe kushtet e Marrëveshjen për Pagesë, ose dështon që me kohë të paguajë tri (3) ose më shumë Fatura të lëshuara pas faljes së Borxheve të Vjetra.

Neni 10: Shlyerja e Borxhit të Vjetër

Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të zbatojnë dispozitat e Rregullores se UNMIK-ut Nr. 2003/17 mbi Shpalljen e Ligjit mbi Menaxhimin dhe Përgjegjësitë e

Financave Publike ose Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit që të përshtatin llogaritë të hyrave në regjistrat e tyre të kontabilitetit dhe raportet financiare që të pasqyrojnë pjesën e Borxheve të Vjetra të cilat mund të jenë falur ose rregulluar në bazë të kësaj Rregulle.

Kapitulli 2: Marrëveshjet për Pagesa dhe Kontestet

Neni 11: Marrëveshjet për Pagesa

- 11.1. Në marrëveshje me Konsumatorin, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do ti lejojë Konsumatorit të paguajë në këste Borxhin e Vjetër gjatë periudhës kohore që nuk tejkalon (12) dymbëdhjetë muaj. Gjithashtu nga Konsumatori do të kërkohet të paguajë edhe Faturat vijuese gjatë periudhës së pagesës në këste në marrëveshje me Ofruesin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza.
- 11.2. Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të konfirmojë me shkrim të gjitha Marrëveshjet për Pagesa dhe do ti lëshojë një kopje Konsumatorit jo më vonë se pesë (5) Ditë të Punës pas datës në të cilën është bërë marrëveshja që t'i mundësojë Konsumatorit të shqyrtojë dhe verifikojë kushtet e dakorduara me Marrëveshje për Pagesë.
- 11.3. Konfirmimi me shkrim i Marrëveshjes për Pagesë i dërguar Konsumatorit në mënyrë të specifike duhet të theksojë se:
 - (a) Dështimi për respektimin e Marrëveshjes për Pagesë do të rezultojë me Shkyçje; dhe
 - (b) Konsumatori ka të drejtë të kontaktojë Komisionin e tyre lokal Këshillues për Konsumatorë brenda dhjetë (10) Ditëve të Punës nga pranimi i konfirmimit me shkrim në qoftë se Konsumatori nuk pajtohet me kushtet e konfirmimit të asaj Marrëveshje për Pagesë.

Neni 12: Kontestimi i Besueshëm i Faturës

- 12.1 Në rast të Kontestimit të Faturës, për cilatdo shuma të caktuara për t'u paguar nën Rregullimin për Pagesë, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza nuk do të ketë të drejtë të Shkyçë Konsumatorin përderisa të përfundojë hetimin.
- 12.2 Hetimi do të përfshijë:
 - (a) Shqyrtimin e shënimeve të Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza për të identifikuar datën dhe shumën e faturave të dërguara të Konsumatori dhe datën dhe shumën e paguar nga Konsumatori, dhe
 - (b) Shqyrtimin e vërtetimit për pagesë të Konsumatorit; dhe
 - (c) Përmbledhjen e rezultateve që tregojnë shumën e Borxheve të Vjetra.
- 12.3 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të i raportojë rezultatet e hetimit të drejtuar në bazë të Nenit 12.1 dhe 12.2 të lartshënuar te Konsumatorët dhe të mbajë shënime me shkrim për një kohë minimale prej dy (2) viteve pasi që rezultatet e hetimit i raportohen Konsumatorit.

- 12.4 Konfliktet e Faturave të cilat nuk mund të zgjidhen në mënyrë mirëdashëse mund të drejtohen tek Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve në kërkesë të Konsumatorit sipas procedurave të krijuara për Komisionin.
- 12.5 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza nuk do të ketë të drejtë të Shkyçë Konsumatorin përderisa Komisioni Këshillues i Konsumatorëve të shpall vendimin në favor të Ofruesit të Shërbimeve dhe të Konsumatorit që nuk është në pajtueshmëri.

Neni 13: Mos Pagesa e Vazhdueshme

- 13.1 Konsumatorët të cilët nuk respektojnë kushtet dhe afatet e Marrëveshjes për Pagesë do të kenë krejt shumat e pagueshme në Faturat e tyre, duke përfshirë të gjitha Borxhet e Vjetra, që janë të caktuara dhe të pagueshme brenda njëzetekatër (24) Ditëve të Punës.
- 13.2 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të përgatisë Faturën që tregon shumën e plotë dhe afatin e pagesës, dhe t'ia dërgojë Konsumatorit.
- 13.3 Mos Pagesa e të gjitha shumave që janë të caktuara për t'u paguar dhe të pagueshme nga Konsumatori në bazë të nën-nenit 13.1 gjithashtu mund të përfundojnë me Shkyçje.

Kapitulli 3: Situatat e Veçanta

Neni 14: Të Varfrit dhe të Vobektit

- 14.1. Konsumatori i regjistruar në Skemën Sociale të Ndhmës Sociale të Kosovës ose Konsumatori i klasifikuar si i varfër dhe i vobektë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle nuk do kërkohet që të paguajë cilindo borxh para vitit 2003.
- 14.2. Pavarësisht nga kufizimet e nën-nenit të lartshënuar 14.1, Konsumatorët e përmendur do të paguajnë të gjitha faturat e lëshuara nga 1 janari i vitit 2003 nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza.

Neni 15: Pronat e Braktisura ose të Boshatisura

- 15.1. Konsumatorët të cilët kërkojnë që Shërbimet e Ujit të rivendosen në Pronat e Braktisura ose të Boshatisura nuk do të jenë përgjegjës për cilëndo Faturë të papaguar ose Borxh të Vjetër i përcjellur nga vitet e kaluara por ata duhet të dëshmojnë që nuk kanë banuar më herët në atë pronë ose ndonjë anëtarë i familjes së tyre ose ndonjë i afërm i tyre, dhe ata duhet të paguajnë taksën për rikyçje.
- 15.2. Nëse Konsumatori ose ndonjë anëtar i familjes ose i afërm i Konsumatorit ka grumbulluar Borxhe të Vjetra në Pronën e Braktisur ose të Boshatisur, atëherë Konsumatori që kërkon vazhdimin e Shërbimeve të Ujit duhet të rregullojë Borxhin e Vjetër sipas këtij Rregulli.

Neni 16: Pronari i Ri ose Banuesi

- 16.1 Konsumatori do të jetë përgjegjës për Faturat e papaguara duke filluar nga periudha e pronësisë së vet ose posedimit.
- 16.2 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të merr parasysht banimin prej një viti të plotë përveç nëse Pronari i Ri ose Banuesi i Ri dëshmon datën kur ka hyrë brenda, në të cilin rast shumat që janë borxh do të jenë vetëm për atë kohën aktuale të posedimit ose të banimit.
- 16.3 Data e banimit mund të dëshmohet me:
- (a) Datën në aplikacioni për shërbime të dorëzuar nga Konsumatori te Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza për Shërbime të Ujit; ose
 - (b) Datën në aplikacionin për shërbime të dorëzuar nga Konsumatori për shërbime të rrymës elektrike ose ngrohjes qendrore; ose
 - (c) Emrin dhe datën e regjistrimit të Pronës së Patundshme; ose
 - (d) Cilindo dokument tjetër zyrtar i cili mund të shërbejë si dëshmi për datën e banimit.
- 16.4 Koha e banimit do të llogaritet në njësi të muajve të plotë duke filluar nga muaji i parë i plotë i banimit. Ditët më pak se një muaj do të përpjesëtohen në bazë të 30 ditëve të muajit.

Kapitulli 4: Shënimet dhe Raportet

Neni 17: Shënimet

- 17.1 Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të mbajnë shënime në Regjistrin e tyre të Konsumatorëve për të dëshmuar në çdo kohë
- (a) Shumën e Borxhit të Vjetër që ka borxh secili Konsumator
 - (b) Shumën e falur të Borxheve të Vjetra në bazë të këtij Rregulli
 - (c) Shumën e mbetur të Borxhit të Vjetër që duhet të paguhet nga Konsumatori e dakorduar me Marrëveshjen për Pagesa; dhe
 - (d) Shumën e Faturave tjera të cilat Konsumatorët i kanë borxh.
- 17.2 Shënimet që organizohen dhe mbahen në bazë të nën-Nenit 17.1 do të jenë konfidenciale dhe do të nënshtrohen inspektimit nga Rregullatori.

Neni 18: Raportet

- 18.1 Për Konsumatorët Institucional dhe Ndërmarrjet Shoqërore (NSH), Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të përgatitë për Rregullatorin një raport përmbledhës që tregon organizatat, shumën e borxhit, periudhën e borxhit dhe gjendjen e shlyerjes së borxhit, dhe do të dërgojë një kopje te Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) dhe te Kryesuesi i Shtyllës së IV/UNMIK.
- 18.2 Për Konsumatorët Ndërkombëtarë, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të përgatisë për Rregullatorin një raport përmbledhës që regjistron

organizatat, shumën e borxhit, periudhën e borxhit dhe gjendjen e shlyerjes së borxhit, dhe do të dërgojë një kopje te Komandanti i KFOR-it dhe Kryesuesi i Shtyllës së IV.

PJESA IV: TË NDRYSHME

Neni 19: Gjuhët Zyrtare të këtij Rregulli


- 19.1. Ky Rregull lëshohet dhe publikohet në tri (3) versione të shkruara në gjuhët zyrtare që përdoren në Kosovë:
- (a) Angleze;
 - (b) Shqip; dhe
 - (c) Serbe.
- 19.2. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të versioneve në të cilat ky Rregull është lëshuar, versioni në gjuhën Angleze do të merret si bazë.

Neni 20: Hyrja në Fuqi

Ky Rregull do të hyjë në fuqi tridhjetë (30) ditë kalendarike pas datës së nënshkrimit.

Neni 21: Afati

Ofruesit e Shërbimeve duhet të kompletojnë faljen dhe rregullimin e borxheve brenda gjashtë (6) muajve kalendarik nga hyrja në fuqi e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturina në Kosovë.



Paulino Brillhante Santos
Drejtor



Afrim Lajci
Zëvendës Drejtor

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

SHTOJCAT

SHTOJCA 1

SHEMBULL I FORMULARIT PËR PËRMBLEDHJEN E BORXHEVE TË VJETRA

KËRKESA PËR PAGESË			
Data		Inspektori i ZRRUM	
Ofruesi i Shërbimeve		Personi Kontaktues	
Konsumatori Ndërkombëtar		Nr. i Kodit të Konsumatorit	

Viti Financiar 2001			
Muaji	E faturuar	E paguar	Bilanci
Janar			
Shkurt			
Mars			
Prill			
Maj			
Qershor			
Korrik			
Gusht			
Shtator			
Tetor			
Nëntor			
Dhjetor			
		GJITHSEJ:	

Viti Financiar 2002			
Muaji	E faturuar	E paguar	Bilanci
Janar			
Shkurt			
Mars			
Prill			
Maj			
Qershor			
Korrik			
Gusht			
Shtator			
Tetor			
Nëntor			
Dhjetor			
		TOTAL:	

Viti Financiar 2003			
Muaji	E faturuar	E paguar	Bilanci
Janar			
Shkurt			
Mars			
Prill			
Maj			
Qershor			
Korrik			
Gusht			
Shtator			
Tetor			
Nëntor			
Dhjetor			
		TOTAL:	

Viti Financiar 2004			
Muaji	E faturuar	E paguar	Bilanci
Janar			
Shkurt			
Mars			
Prill			
Maj			
Qershor			
Korrik			
Gusht			
Shtator			
Tetor			
Nëntor			
Dhjetor			
		GJITHSEJ:	

SHTOJCA 2

MODELI I KONTRATËS PËR MARRËVESHJEN E PAGESËS

MODELI I KONTRATËS PËR PAGESËN E BORXHEVE TË VJETRA DHE BORXHEVE VIJUESE NDAJ OFRUESIT TË SHËRBIMEVE TË UJIT DHE UJËRAVE TË

[REDACTED]
(Emri i Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza)

[REDACTED]
(Adresa e Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza)

[REDACTED]
(Emri i Komunës)

Nr. i Referencës së Ofruesit të Shërbimeve: [REDACTED]

Nr. Identifikues i Konsumatorit: [REDACTED]

Datë: [REDACTED] Nr i Llogarisë së Konsumatorit: [REDACTED]

KONTRATË PËR PAGESËN E BORXHEVE TË VJETRA

Kjo kontratë është bërë për të bërë të ditur vlerën dhe për të paguar Borxhin e Vjetër dhe Borxhin Vijues për Shërbimet e Ujit dhe Ujërave të Zeza në vlerë ("Kontrata") në [REDACTED], Kosovë, më date [REDACTED], 200_

NDËRMJET

(1) [REDACTED] Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza ("Ofruesi i Shërbimeve") dhe

(2) [REDACTED] me Nr. të ID [REDACTED], dhe adresë kryesore

[REDACTED] ("Konsumatori").

Që referohen individualisht si "Palë" dhe kolektivisht si "Palët".

PËRSHKRIMET

Duke marrë parasysh se Konsumatori e ka të njohur:

- (a) ka qenë i kyçur në Rrjetin e Ujit që operohet nga Ofruesi i Shërbimeve, qoftë me kyçe ligjore apo kyçe jo ligjore, dhe nuk e ka shlyer llogarinë e papaguar, dhe
- (b) Konsumatori njeh që ai ose ajo nuk është identifikuar si Konsumatorë i Cenueshëm.

Duke marrë parasysh se Palët pajtohen që Ofruesi i Shërbimeve në mënyrë të kënaqshme ka demonstruar që ka në shënimet e tij informatat vijues:

- (a) emrin dhe adresën e saktë të Konsumatorit; dhe/apo
- (b) historinë e pagesave të konsumatorit në dosjen e tij, duke përfshirë shënimet e orës atëherë kur ka qenë e mundur, dhe

Duke marrë parasysh se Palët pajtohen që kjo Kontratë është lidhë në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut, Rregullin mbi Faljen dhe Shlyerjen e Borxheve të Vjetra dhe Rregullin mbi Shkyçjen e Shërbimeve të Ujit;

Prandaj, në frymën e asaj që u tha më lartë, Palët me këtë pajtohen si vijon:

1. **Përkufizimet:**

“Borxhi i Vijues” nënkupton të gjitha borxhet e evidentuara nga Faturat e pakontestuara të lëshuara nga Ofruesi i Shërbimeve tek Konsumatori me apo pas 1 janar 2003, i cili që nuk është paguar krejtësisht ashtu si është definuar në Rregullin për Falje dhe Shlyerje të Borxhit të Kaluar nga Rregullatori;

“Llogaria e Papaguar” nënkupton llogarinë në mes të Konsumatorit dhe Ofruesit të Shërbimeve e cila nuk është rregulluar (paguar) nga Konsumatori në frymën e zakonshme të afarizmit, në lidhje me Borxhin e Vjetër dhe atë Vijues, kur Konsumatori ka marrur Faturat me kohë dhe ka pasë një afat të arsyeshëm për ti paguar.

“Fatura” nënkupton dokumentin e lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve tek Konsumatori i cili shënon shërbimet e kryera, mallrat e dorëzuara, Tarifat e Aplikueshme të Shërbimeve, çmimet e tyre apo taksat e aplikueshme, çfarëdo takse apo gjobe zyrtare, dhe shumën totale që ka borxh Konsumatori. Ofruesi i Shërbimeve mundet, sipas vendimit të tij, nëse i kërkohet me ligj apo caktohet nga Rregullatori kohë pas kohe, të përfshijë informata shtesë;

“Borxh i Vjetër” nënkupton të gjitha borxhet e Konsumatorit të evidentuara nga Faturat e pakontestueshme të lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve tek ai Konsumator me apo para 31 dhjetorit 2002, që nuk janë paguar në tërësi siç është përcaktuar në Rregullin e lëshuar nga Rregullatori mbi Faljen dhe Zgjedhjen e Borxheve të Vjetra;

“Konsumator i Cenueshëm” nënkupton:

- çfarëdo Personi që është i certifikuar nga ndonjë mjek se i është i rrezikohet jeta ose shëndeti pa Shërbimet e Ujit dhe Ujërave të Zeza;

- secili Konsumatorë i klasifikuar nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale n; pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/28, Ligji Nr. 2003/15 Mbi Skemën e Asistencës Sociale në Kosovë, si i varfër dhe skamnor, dhe i këshillohet Ofruesit të Shërbimeve që ti mundësohet që faturën e tij ta paguajnë autoritetet e mirëqenies sociale;

Të gjitha shprehjet e tjera dhe frazat e përdorura në këtë kontratë me fjalët e shkruara me shkronja të mëdha do të renditen dhe interpretohen ne përputhje me definicionet e ofruara në Rregulloren e UNMIK-ut dhe në Rregullin mbi Faljen dhe Zgjedhjen e Borxheve të Vjetra,

2. Pranimi dhe Saktësia e Faturës:

- (a) Me këtë Konsumatori pranon se i ka pranuar Faturat, të bashkangjitura në këtë Kontratë, nga Ofruesit të Shërbimit dhe se ato Fatura saktësisht reflektojnë shumën e plotë të Llogarisë së Papaguar që Konsumatori i ka mbetur Ofruesit të Shërbimeve
- (b) Me këtë Konsumatori më tutje pranon se të gjitha borxhet e përfshira me këtë Kontratë janë shkaktuar gjatë periudhës që ka filluar prej datës [REDACTED] të muajit [REDACTED], XXXX dhe ka mbaruar me datën [REDACTED] të muajit [REDACTED], XXXX.
- (c) Pagesa që duhet të bëhet nga Konsumatori siç është përcaktuar në këtë Kontratë duhet të përmbajë pagesën e plotë të gjitha borxheve të Konsumatorit ndaj Ofruesit të Shërbimit.

3. Afatet e Pagesës:

- (a) Pagesa e Plotë sa i përket Konsumatorëve të Regjistruar dhe Faturuar: Konsumatori me këtë pranon obligimin e tij që të paguajë Llogarinë e tij të Papaguar ndaj Ofruesit të Shërbimit për shumën totale prej [REDACTED] EUR ashtu siç është paraqitur në Faturën e lëshuar nga Ofruesi i Shërbimit në vijim të kësaj Kontrate dhe të bashkangjitur me të;
- (b) Nuk do të Paguhet Kamata: Ofruesi i Shërbimeve nuk do të aplikoj kamatë në shumën që duhet të paguhet për të rregulluar Llogarinë e Papaguar.
- (c) Plani i Pagesës: Ofruesi i Shërbimeve me këtë ofron, dhe Konsumatori pranon që të paguaj shumën e plotë të Faturës sipas një Marrëveshje për Pagesë që përbëhet prej pagesës së kësteve mujore të njëjta, në shumë prej [REDACTED] EUR (shkruani shumën me shkronja) për [REDACTED] muaj, duke filluar me pagesën e parë që duhet të bëhet më date [REDACTED].

4. Të Tjera

- (a) Ligji Qeverisës dhe Kontestet: Kjo Kontratë dhe të drejtat dhe obligimet e Palëve që dalin nga kjo do të qeveriset, interpretohet dhe shpjegohet duke u bazuar në ligjet e Kosovës dhe çfarëdo kundërthënie tash e tutje do të jetë çështje për zgjedhje në gjyqet e Kosovës.
- (b) Marrëveshja e Plotë: Kjo Kontratë, së bashku me Faturën e bashkangjitur, paraqet marrëveshjen e tërësishme në mes të Palëve në lidhje me pagesën e borxhit, dhe mbizotëron mbi të gjitha marrëveshjet paraprake me gojë ose me shkrimi në mes të Palëve që kanë të bëjnë me këtë Kontratë.

- (c) Bartja: Palët pajtohen që: Ofruesi i Shërbimit nuk do të ketë të drejtë me këtë Kontratë që ti bartë ndonjë apo të gjitha të drejtat dhe interesat e veta çfarëdo personi tjetër pa pëlqimin e konsumatorit; dhe se Konsumatori me këtë Kontratë nuk do të jetë në gjendje që ti barti të drejtat apo obligimet ndonjë personi të tretë pa marrur pëlqimin me shkrim nga Ofruesi i Shërbimit.
- (d) Palët: kjo kontratë është lëshuar në dy (2) kopje origjinale, ku secila nga palët do të mbajë nga një kopje.

SI DËSHMI se kjo Kontratë është ekzekutuar në ditën e parë të shkruar më lartë nga:

Për dhe në emër të: _____
(Emri i Ofruesit të Shërbimeve)

Përfaqësuar nga: _____
(Emri i Përfaqësuesit të Autorizuar)

Nënshkrimi: _____ Datë: _____

Për dhe në emër të: _____
(Emri i Konsumatorit)

Përfaqësuar nga: _____
(Emri i Përfaqësuesit të Autorizuar)

Nënshkrimi: _____ Datë: _____